



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28.10.2015, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha përfaqësuese e LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së.

Munguan: Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Osman Bllaca, këshilltarë i Kryetarit.

Mbledhjen e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Kryesuesi** tha se ka ardhur një kërkesë prej Ministrisë për përkrahje, për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelegjencë të Jashtëzakonshme ATOMI.

Lirak Çelaj tha të futet në rend dite Kërkesa për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelegjencë të Jashtëzakonshme ATOMI dhe Shqyrtimi i ndarjes së lokacionit për kishën dhe varrezat protestante

Dardan Sejdiu u pajtua që në rend dite të hyjë edhe lokacioni për varreza dhe kishën protestante.

Kryesuesi tha se anëtarët e Komitetit u pajtuan që në rend dite të hynë si pika :

5. Shqyrtimi i ndarjes së lokacionit për kishën dhe varrezat protestante

dhe 6. Kërkesa për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelegjencë të Jashtëzakonshme ATOMI

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

RENDI I DITËS :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë .
2. Raporti gjashtë mujor buxhetor janar - qershor 2015.
3. Raporti tremujor buxhetor korrik – shtator 2015.
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014.
5. Shqyrtimi i ndarjes së lokacionit për kishën dhe varrezat protestante.
6. Kërkesa për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelegjencë të Jashtëzakonshme ATOMI.
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Qëndron Kastrati tha se në mbledhjen e kaluar është ngritur çështja e petitionit të banorëve të lagjes "Prishtina e Re" lidhur me Planin Urbanistik ku kërkesë ka qenë me trajtuar si propozim drejtoria e Urbanizmit kërkesën e palëve e jo si vendim i prerë. Andaj kërkoi që të futet në ekstrakt *se ka qenë kërkesë me trajtuar si propozim drejtoria e Urbanizmit kërkesën e palëve e jo si vendim i prerë.*

Lirak Çelaj tha se ka qenë kërkesë që atyre me ju bë zgjidhje.

Kryesuesi dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Lirak Çelaj tha se dokumenti nuk është vendim që i përket qëndrimit të asamblistëve, nuk është përpiluar konform vendimit të anëtarëve të Kuvendit që Urbanizmi me zhvilluar procedurën rreth petitionit.

Sami Hamiti tha se në Kuvend do ta ngritë çështjen e Peticionit dhe emërtimit të rrugëve ku do të kërkoj rishikimin e emërtimeve të rrugëve që të kthehen mbrapa ato vendime se ai komision nuk e ka pasur të drejtën e ndryshimit të emërtimeve të rrugëve të vjetra.

Kryesuesi konstatoi se, me vërejtjen e dhënë nga Qëndron Kastrati njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë dhe e tretë

Raporti gjashtë mujor buxhetor janar - qershor 2015 dhe

Raporti tremujor buxhetor korrik – shtator 2015.

Dardan Sejdiu tha se në Kuvend kryetari do të raportoj për Raportin gjashtë mujor buxhetor janar - qershor 2015 dhe Raportin tremujor buxhetor korrik – shtator 2015.

Sami Hamiti tha se këto raporte është dashur të hyjnë rend dite më herët. Ai ceku se i ka trajtuar dy raportet dhe si kërkesa pak a shumë lidhen, shumica janë në përmbajtje përveç raporteve të inkasimeve dhe shpenzimeve. Ai shtoi se te projektet Kapitale mungojnë disa kode se cilat projekte me kode janë tu zbatuar dhe cilat nuk janë tu

zbatuar po ashtu i mungon deklarata e kryetarit fund se nuk përkon me gjendjen financiare që është në Komunën e Prishtinës.

Qëndron Kastrati tha se jem të shqetësuar për raportin e inkasimeve dhe shpenzimeve ku konsiderojmë se te sektorët e caktuara ka ngecje dhe ka nevojë për ndryshime. Ai ceku se do ti drejtohem ekzekutivit të bëjë një analizim të thellë dhe me marrë masa për veprime në të ardhmen.

Lirak Çelaj parashtrori si kërkesë që të sillet lista e investimeve kapitale të infrastrukturës rrugore dhe të zbërthehen për seancën komunale.

Imer Rusinovci pajtohet të shkojnë në Kuvend këto raporte.

Laura Zherka tha te trajtimi i qeneve endacak është futur te shpenzimet kapitale kjo nuk është shpenzim kapital andaj të shikohet kjo çështje, po ashtu edhe për projektin e Kogjenerimit të Ndërmarrjes Komunale,,Termokos'' pyeti a është kapital.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me këto çështje.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah me plotësime Raporti gjashtë mujor buxhetor janar - qershor 2015 dhe Raporti tremujor buxhetor korrik - shtator 2015 dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014.

Sami Hamiti sa i përket raportit të auditorit ai ka vërejtje te auditori ku pasojat dhe problemet janë te mos funksionimi i mirë i zyrës së auditorit të brendshëm të Komunës. Ai kërkoi nga nënkryetarit që t'ia përcjellë kryetarit si kërkesë që për mbledhje të Kuvendit t'ia bashkangjesë materialit një informatë se kush është në Komitetin e auditorit që të merr përgjegjësi pse s'ka plan të punëve të brendshme të auditorit dhe pse s'ka plan për përmbajtjen e rekomandimeve që janë këtu.

Qëndron Kastrati tha se e përkrahim raportin e auditorit të shkoj në Kuvend e atje do të diskutojmë.

Laura Zherka u interesua se a ka funksionuar komiteti i auditorit në vitin 2014 dhe a funksionon tani në vitin 2015 ky komitet.

Osman Billaca tha se komiteti i auditorit ka funksionuar në vitin 2014 është themeluar në nëntor të vitit 2014 në përbërje prej 3 anëtarëve dhe ka mbajtur dy mbledhje, edhe në vitin 2015 ka funksionuar dhe ka mbajtur një mbledhje.

Lirak Çelaj tha se në Kuvend do të diskutojmë lidhur me raportin e auditorit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah me plotësime Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Shqyrtimi i ndarjes së lokacionit për kishën dhe varrezat protestante.

Dardan Sejdiu tha se do të kërkoj nga drejtorja e pronës që ta informojnë se deri ku kanë arritur lidhur me kërkesën për caktimin e lokacionit për kishën dhe varrezat protestante.

Lirak Çelaj tha se do të dalim me kërkesë për parcelë të caktuare ,mirëpo shpreson se do të ndahet parcela dhe të jetë vendim i prerë.

Dardan Sejdiu dha se pajtohet me z.Lirakun të që vij në Kuvend kjo kërkesë dhe të shqyrtohet , se kërkesën e tyre e kanë marrë kaherë është diskutuar me drejtorinë përkatëse dhe ka pasur kohë drejtoria përkatëse me trajtuar këtë çështje.

Kryesuesi tha mbetet ekzekutivi me drejtorin e pronës me sjellë propozim me një lokacion për kishën dhe varrezat protestante për Kuvend, pra të shikohet deri ku ka arritur kjo kërkesë për kishën dhe varrezat dhe në Kuvend të vendoset a të miratohet a jo.

Lirak Çelaj tha qe dy vite nuk është ndërmarrë asgjë le të jenë tek e fundit le të jenë edhe varreza të përkohshme derisa të kryhet projekti për kishën dhe varrezat e përbashkëta dhe kurë të vij projekti për varreza të përbashkëta do ti përkrahim.

Qëndron Kastrati tha se është interesuar në varrezat në Dragodan ka varreza me shenja të krishterizmit . Ai tha se nuk pajtohet me pas ndarje të atyre varrezave.

Sami Hamiti tha se kjo kërkesë e protestanteve është e kahershme dhe nuk është kryer andaj të qitet propozimi për lokacion për kishën dhe varrezat protestante dhe të shqyrtohet në Kuvend .

Kryesuesi konstatoi se u përkrah që të sillet për Kuvend nga drejtoria e Pronës propozimi për lokacionin për kishën dhe varrezat protestante dhe të shqyrtohet.

Pika e gjashtë

Kërkesa për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelgjencë të Jashtëzakonshme ATOMI.

Lidhur me **Kërkesën për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelgjencë të**

Jashtëzakonshme ATOMI, Dardan Sejdiu tha se a pajtohen të pranishmit të trajtohet në Kuvend kjo kërkesë dhe të shqyrtohet.

Sami Hamiti tha se pajtohet të shkoj kjo kërkesë për Kuvend. Mirëpo propozoi që Drejtoria e Arsimit me sjell për akomoditim një propozim se ka hapësirë në SHML'' Gjinnazi Matematik''.

Kryesuesi tha mbetet që Drejtoria e Arsimit të sjellë një pëlqim pra një propozim se ka hapësirë në SHML'' Gjinnazi Matematik'' dhe me ja bashkangjitur kërkesës .

Qëndron Kastrati tha se drejtoria e Arsimit nuk mund të përzihet ajo mundet vetëm me treguar lidhur me hapësirën e shkollës ndërsa ligjërisht Ministria e Arsimit i drejtohet me shkresë Kryetarit të Komunës ,organ vendim marrës për me marrë vendim për hapësira publike është Kuvendi Komunal dhe kryetari i drejtohet kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që Drejtoria e Arsimit të sjellë një pëlqim pra një propozim se ka hapësirë në SHML'' Gjinnazi Matematik''dhe me ja bashkangjitur **Kërkesës për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave të SHML'' Gjinnazi Matematik'' për Institutin Ndërkombëtar për Intelgjencë të Jashtëzakonshme ATOMI dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

Të ndryshme

Sami Hamiti i njoftoi të pranishmit rreth një shkrese të kryetarit të Komuës dërguar Ndërmarrjeve publike Lokale e cila ka të bëjë rreth emërtimit të anëtarëve të ri të Komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale. Lidhur me këtë konsideroj se është një ndërhyrje ligjore nga ana e Kryetarit. Më pas shtoi emërimi i anëtarëve të ri është bërë në bazë të vendimit të Kuvendit, e që aj vendim është i ligjshëm dhe duhet të zbatohet.

Qëndron Kastrati shprehi shqetësimin lidhur me një vendim të dy anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen „Termokos”ku kanë bërë shkelje ligjore dhe sipas tij është falsifikim. Ai ceku se Komisioni komunal i Aksionarëve është organ i komunës së Prishtinës dhe në vendimet e komisionit komunal të aksionarëve nuk mundet me përdor vulën e ndërmarrjes se janë dy organe të ndryshme. Ai ceku se kanë shkuar dhe e kanë përzgjedhur anëtarë tash jo të ligjshëm ku dy persona nuk mundën me marrë vendime.

Çështje tjetër që ceku është se kanë zgjedhur një person anëtar Bordi i cili është i zgjedhur edhe në një Ndërmarrje tjetër publike që është në kuadër të Komunës së Prishtinës.

Po ashtu njoftoi se janë duke u përgatitur me ndjek një kallëzim penal ndaj dy asambleistëve Muhamet Selmani dhe Ajnishahe Azemi për këto shkelje edhe me Raport me dëshmi që i kanë mbi të cilat ata janë thirre. Ai tha se sipas tyre ai nuk është vendim dhe nuk e trajtojnë.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z.Qëndron Kastrati ,**Lirak Çelaj** tha se i kanë marrë interpretimet nga Ministria përkatëse ekziston edhe vendimi i gjykatës lidhur me këtë çështje. Për këtë çështje mund të iniciohet edhe kallëzim penal mirëpo procedurat ligjore janë përfillë në përpikëri.

Mbledhja përfundoi në orën 16:35

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi dhe
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.